



BASHKIA VORE

PROJEKT - BUXHET

2017

2016



Përmbajtja :

Kapitulli I. Programi Buxhetor dhe Prioritet e Tij.....	5
Kapitulli II. Të Ardhurat e Bashkisë Vorë Për Vitin 2017	8
1. Të ardhurat nga burimet e veta vendore	
1.1 Të ardhurat nga taksat vendore	
1.2 Të ardhura nga tarifa vendore	
1.3 Të ardhura nga burime të tjera	
2. Të ardhurat nga burimet qëndrore	
2.1 Transferta e pakushtëzuar	
2.2 Transferta e Kushtëzuar	
2.3 Transferta specifike sipas funksioneve	
2.4 Fondi I Zhvillimit të Rajoneve	
Kapitulli III. Parashikimi I Shpenzimeve Për Vitin 2017.....	17
1. Shpenzime Personeli	
2. Shpenzime Operative	
Kapitulli IV. Programet Buxhetore	20
1. Programi Buxhetor i Administratës	
2. Programi Buxhetor i Shërbimeve Publike Vendore	
3. Programi i Buxhetor i Isfrastrukturës Rrugëve	
4. Programi i Buxhetor i Arsimit, Kulturës, Rinisë dhe Sportit	



MESAZH I KRYETARIT TË BASHKISË VORË

Të nderuar!

Buxheti nuk është thjeshtë një përmbledhje e shifrave dhe treguesve financiarë. Por është një lidhje e fortë midis fondeve në dispozicion, qëllimeve, objektivave dhe politikave të institucionit tonë, të cilat duhet të arrihen brënda vitit buxhetor, ndaj dhe planifikimi i buxhetit është arti i qeverisjes sonë.

Duke lënë pas një vit të vështirë buxhetimi për shkak të reformës administrative, le të nisim një vit tjetër sëbashku me plane dhe projekte që përshkruajnë rrugën e zhvillimit ekonomik, infrastrukturor, bujqësor, social-kulturor të bashkisë Vorë, duke ofruar standarte të larta dhe duke krijuar një klimë sa më tërheqëse për investime të kapitalit vendas dhe të huaj.

Unë, ne, Bashkia Vorë, duam të punojmë mirë, me përgjegjësi, duke zbatuar me rigorozitet ligjin, me transparencë, duke përdorur paratë në mënyrë eficiente për gjërat e duhura, me besimin se vetëm kështu mund të ndryshojmë dhe të zhvillohemi.

Projekt-buxheti është një proces i gjatë analizash, projektsh, problemeve dhe sfidave emergjente, programeve afatshkurtra dhe afatmesme. Në qëndër të angazhimit të politikave dhe projekteve të Bashkisë është zhvillimi ekonomik, punësimi dhe përmiresimi i infrastruktures në Vorë, Prezë, Bërxullë dhe Domje, në çdo cep të zonës duke përmirësuar cilësinë e jetës së qytetarëve. Për një qytet ku bashkëjetojnë tradita me modernen, ku të rinjtë realizojnë aspiratat e tyre për shkollim dhe punësim, ku të moshuarit jetojnë ditë të bardha, një qytet që ka gjithmonë një dorë të zgjatur për të nxjerrë nga vështirësia dhe ku problemi yt gjen një zgjidhje.

Gjatë këtyre muajve komunikimi me njerëzit, takimet e diskutimet publike kanë ndihmuar për të përcaktuar shqetësimet dhe nevojat aq të shumta dhe me mundësi të kufizuara për t'u realizuar në një kohë afat-shkurtër

Rruga jonë ka qenë e vështirë, udhëtimi ynë ka qenë i gjatë, ne kemi ngritur, ne kemi shërbyer, ne kemi punuar për të realizuar sfondin që shohim sot në vëndin tonë, ne kemi realizuar ëndërrën tonë.

Duke punuar dhe shërbyer në këtë rrugë me vlera njerëzore, të drejtë e të mirë të progresit, të zhvillimit, të mirqënies, të prosperitetit, të integritetit do të realizohet çdo objektiv, çdo detyrë, çdo tregues i këtij projekt-buxheti. Duke u kombinuar me vizionin, përkushtimin, strategjinë e mirëpërcaktuar dhe projektet specifike për sektorë të vecantë ofron mundësi më të mira për plotësimin e nevojave të komunitetit, në përputhje me trendin e zhvillimit të zonës dhe të Shqipërisë.

Unë dua t'ju siguroj se administrata ime do jetë gjithëpërfshirëse, duke përfaqësuar kështu familjen e përbashkët.



Bashkia Vorë

Të vendosur , të mirëorganizuar, të motivuar, do të jemi në vëndin e duhur, në kohën e duhur, me njerzit e duhur duke bërë punën e duhur, me vlera dhe qëllime të larta njerëzore dhe ligjore gjithnjë në shërbim të komunitetit.

Ne jemi dhe gjithnjë do të mbetemi një qeverisje vendore e përkushtuar ndaj vlerave të demokracisë, vlerave njerëzore, zbatimit të ligjshmërisë me aftësi profesionale në shërbim të komunitetit.

Unë besoj që bashkë me ju, me bashkeqytetarët, me shumë punë e përkushtim do të marrim dhe përmbushim përgjegjësitë për të administruar dhe zhvilluar qytetin e Vorës.

“Ne nuk po punojmë vetëm për vitin e ardhshëm, por për brezat e ardhshëm”.

Unë besoj në punën dhe kontributin tuaj !

Fiqiri Ismaili

Kryetar



KAPITULLI I Programi Buxhetor Dhe Prioritet e Tij

Kuadri ligjor që rregullon procesin e hartimit të buxhetit vendor përshkruan qartë se si duhet të organizohet procesi i buxhetimit duke përfshirë zbatimin e buxhetit dhe monitorimin e tij. Kjo kornizë bazohet te:

- Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vërtëqeverisjen vendore”,
- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit e buxhetor në Republikën e Shqipërisë”,
- Ligji nr 57/2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit e buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.
- Ligji Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar me ligjin Nr.142/2015 datë 17.12.2015,
- Ligji nr.147, date 17.12.2015 “Per buxhetin e vitit 2016”
- Udhëzimi nr.4 , datë 29.02.2016, “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2017-2019, si dhe Udhëzimi Nr 4/1 datë 29 02 2016 –“Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm për Pushtetin Vendor”.
- Udhëzimi nr. 23 datë 22.11.2016, “Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”.

Ky projekt buxhetit i Bashkisë Vorë për vitin 2017-2019, është një instrument i rëndësishëm financiar që përveçse të promovojë transparencën, duhet të ketë një impakt të gjerë në Bashkinë Vorë, duke përfaqësuar qoftë zonën urbane, qoftë zonat rurale që janë bashkuar në kuadër të reformës territoriale, si dhe të rikthejë mbrapsht në shërbime e investimeve të ardhurat e mbledhura nga komuniteti në formën e taksave dhe tarifave vendore.

Ky buxhet përmban dhe përshkruan :

- Se si do të reflektohen në buxhetin e vitit 2017 politikat fiskale të aplikuara dhe të miratuara.
- Si do të ndikojnë këto politika në përmbushjen e objektivave të Bashkisë.
- Si janë vendosur prioritetet për vitin 2017 për investimet kapitale, duke i koordinuar ato edhe me politikat e investimeve të pushtetit qendror.
- Si do te realizohen shpenzimet për përmbushjen e funksioneve ekzistuese dhe atyre që i janë transferuar pushtetit vendor në fund të vitit 2016.
- Transformimin e programeve politike në programe konkrete zhvillimi, investimi, përfaqësimi.



➤ **Prioritetet e Programit Buxhetor Afatmesëm**

Prioritetet afatmesme të reflektuara në PBA 2017-2019 mbështeten në kërkesat e qytetarëve të Vorës dhe në Programin e Kryetarit të Bashkisë për mandatin 2015-2019.

Shtyllat kryesore në të cilat është mbështetur hartimi i buxhetit afatmesëm do të jenë pikërisht këto synime:

- Rritja e cilesisë së jetës
- Rritja e shanseve për punësim
- Zhvillimi ekonomik i bashkisë Vorë
- Zhvillimi infrastrukturës për biznesin
- Përkrahje sociale
- Investime në rrugë
- Investime në infrastrukturën arsimore
- Zhvillimi i aktiviteteve kulturore dhe sportive

Programet prioritare ku do të përqëndrohet puna e Bashkisë për vitin 2017 paraqiten si vijon:

1. Infrastruktura rrugore

Investimet në këtë program do të përmbushin impenjimet e Kryetarit, për rehabilitim të rrugëve, duke aplikuar standartet më të larta, në gjithë territorin e Bashkisë Vorë. Duke i dhënë përparësi sigurisë në rrugë, gjatë vitit të ardhshëm do të synohet rikualifikimi tërësor i gjithë infrastrukturës horizontale dhe vertikale. Në kuadër të reformës administrative dhe zgjerimit të territorit të Bashkisë Vorë, vitin e ardhshëm shumë investime do të jenë të përqëndruara edhe në njësitë administrative, si dhe do të përfundohen investimet e nisura në këto zona. Fondi për investimet në Infrastrukturen rrugore perbejne rreth 53% te totalit te buxhetit.

2. Shërbimet publike.

Në përmbushje të qëllimit të politikës, objektivate këtij programi fokusohen në zhvillimin dhe mirëmbajtjen e hapësirave publike, rritjen e cilësisë së jetesës së qytetarëve shtimin e sipërfaqeve të gjelbëruara si dhe përmirësimi cilësor i shërbimit e kapaciteteve të pastrimit të qytetit dhe zonave. Gjatë vitit të ardhshëm do të rikonceptohen dhe strukturohen zonat dheshërbimet e pastrimit në gjithë territorin e Vorës, duke bërë edhe diferencimin e mbetjeve urbane, duke i dhënë përparësi kështu riciklimit. Pësha e programit buxhetore te shërbimeve publike ,vendore eshte 13 % e totalit te buxhetit

3. Shërbimet sociale.

Kujdesi Social është gjithashtu një prioritet, duke synuar përmirësimin e jetës së çdo qytetari. Ardhja në ndihmë nëpërmjet ndihmave financiare për njerëz dhe familje në nevojë, si dhe për ato që vuajnë nga sëmundje të rrezikshmësisht një ndër angazhimet e bashkisë edhe për vitet e ardhshme.

Sigurimi i mbulimit të plotë të nevojave ekonomike dhe sociale të familjeve dhe individëve të qytetit të Vorës, duke i riintegruar përfituesit në ambientin shoqëror, duke harmonizuar



programet e mbrojtjes dhe të zhvillimit social, duke i transformuar në një instrument aktiv të zhvillimit shoqëror është qëllimi i këtij program.

Për vitin 2017 për këtë program do të financohet me një fond total në shumën rreth 10.000.000 lekë që përbën 2 % të totalit të buxhetit të Bashkisë Vorë.

➤ **Struktura e Programit Buxhetor Afatmesëm**

PBA-ja është hartuar në bazë të programeve, ku mendimi i qytetarëve dhe programet, lidhen me funksionet respektive të pushtetit vendorë të përcaktuara me ligj. Programet pjesëmarrëse në Programin Buxhetor Afatmesëm janë:

- a. Programi Buxhetor i Shërbimeve Publike Vendore;**
- b. Programi i Buxhetor i Infrastrukturës Rrugëve;**
- c. Programi Buxhetor i Administratës;**
- d. Programi i Buxhetor i Arsimit Kulturës, Rinisë, dhe Sportit;**
- e. Programi Buxhetor i Shërbimeve dhe Kujdesit Social;**

Çdo program përfshin të gjitha shpenzimet që do të shërbejnë për realizimin e objektivave të tij, të detajuara sipas klasifikimit ekonomik në:

- a. Shpenzime korente** (paga, sigurime, shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes, etj.);
- b. Shpenzime kapitale.**

Buxheti i Bashkisë Vorë për vitin 2017 vazhdon të jetë një buxhet i balancuar ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve. Ai është projektuar në vlerën 661,324,630 lekë.

**KAPITULLI II. TË ARDHURAT E BASHKISË VORË PËR VITIN 2017**

Sipas nenit 34 të ligjit 139/2015 “Përvetëqeverisjen vendore”, pika 3 dhe 4, njësitë e vetëqeverisjes vendore financohen nga të ardhurat që sigurohen nga taksat, tarifatat dhe të ardhurat e tjera vendore, nga fondet e transferuara nga qeverisja qendrore dhe fondet që u vijnë drejtëpërdrejt atyre nga ndarja e taksave dhe tatimeve kombëtare, huamarrja vendore, donacione, si dhe burime të tjera të parashikuara në ligj. Njësitë e qeverisjes vendore u garantohet me ligj e drejta për krijimin e të ardhurave në mënyrë të pavarur si dhe të shpenzojnë të ardhurat që janë të domosdoshme për ushtrimin e funksioneve të tyre.

Ligji nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, me ndryshimet përkatëse, përbën ligjin bazë i cili përcakton rregullat për ushtrimin e të drejtave dhe detyrimeve të njësisë të qeverisjes vendore në drejtim të taksave vendore, mbledhjes dhe administrimit e tyre.

Mbështetur në këtë të drejtë ligjore , përcaktohen dy burime financimi :

1. **Të ardhurat nga burimet e veta** vendore, ku përfshihen të ardhurat tatimore (taksat vendore) dhe të ardhurat jo tatimore (tarifat vendore dhe të ardhura te tjera vendore).
2. **Të ardhurat nga niveli qendror** , ku përfshihen transfertat e kuzhtëzuar dhe transfertat e pakushtëzuar, transfertat specifike për funksionet e reja të bashkisë Vore si dhe Fondi i Zhvillimit Rajonal (grantet konkurruese që përdoren për financimin e projekteve kapitale).

Të ardhurat e përgjithshme të Bashkisë Vorë për vitin 2017 , nga të gjitha burimet e financimit duke përfshirë dhe të ardhurat e trashiguara nga viti i mëparshëm, parashikohen të jenë 661,324,630 lekë.

Emërtimi	Fakti 2016	Parashikimi 2017
Të ardhura nga taksat dhe tarifatat vendore	316,259,489	405,226,000
Të ardhura të trashiguara nga viti i mëparshëm .	49,571,836	11,664,696
Transferta e pakushtëzuar	86,140,000	114,534,000
Transferta specifike	36,187,257	55,428,000
Donacione nga FZHR-ja	-	74,471,934
T O T A L I	488,158,582	661,324,630



II. 1 Të ardhurat nga burimet e veta vendore

Të ardhurat e veta vendore përfshijnë të gjitha burimet e të ardhurave tatimore dhe jo tatimore, këto të ardhura bashkia i përdor për financimin e funksioneve të përcaktuara me ligj për njësitë e qeverisjes vendore. Veprimtaria e Bashkisë së Vorës në fushën e sistemit fiskal vendor funksionon mbështetur në bazën ligjore, si më poshtë:

- Ligjin nr.9920 datë 26.05.2008 “Për procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë“ i ndryshuar
- Ligjit nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, me ligjin 181/2013 dt 28/12/2013, botuar ne fletoren zyrtare nr.203, dt.30/12/2013 “Per disa ndryshime dhe shtesa me ligjin nr.9632, dt.30/08/2006 “Per sistemin e taksave vendore i ndryshuar“.
- Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.____, datë _____.____.2016 “Për Miratimin e paketës fiskale për vitin 2017”

Planifikimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifrat për vitin 2017 është i mbështetur në Paketën Fiskale të Bashkisë Vorë, në të cilën përcaktohen llojet e taksave, bazën e taksueshme, kategorizimet dhe nënkategorizimet, kështu e pagimit, kohën e kryerjes së tyre, kushtet lehtësuese, strukturat përgjegjëse për vjeljen e detyrimeve dhe agjentët tatimorë.

Gjithashtu planifikimi i të ardhurave të veta u realizua në sajë të frymës së bashkëpunimit me administratën e bashkisë, me Njësitë Administrative Prezë dhe Bërxullë. Ky proces bashkëpunues do të mundësojë sigurimin e të ardhurave të mundshme për përmirësimin e mëtejshëm të shërbimeve që ofron bashkia ndaj qytetarëve të saj, duke realizuar objektivat madhorë në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm të të gjithë territorit të bashkisë.

II.1.1 Të ardhurat nga taksat vendore

Për vitin fiskal 2017 këto të ardhura arrijnë në shumën *244,187,000 lekë*. Në këtë grup të ardhurash, peshën kryesore specifike e zë zëri “ taksa mbi ndërtesën”, taksa mbi pasuritë e paluajtshme (ndërtesa + toke bujqësore), si dhe zëri “takse e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja”.

Bashkia garanton funksionimin e saj duke përfituar burime financimi kryesisht nga taksat vendore të miratuara sipas akteve ligjore dhe të miratuara me vendime të Këshillit Bashkiak, ku përfshihen :

a. Të ardhura nga Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël

Sipas ligjit 142/2015 dt 17.12.2015, “Për disa ndryshime dhe shtesa me ligjin 9632, date 30/08/2006“Për sistemin e taksave vendore”, neni 11 ndryshon dhe:

- shkalla tatimore për subjektet me xhiro nga 0 deri në 5 milion është 0 Lekë,



- ndërsa shkalla tatimore për subjektet me xhiro nga 5 milion deri në 8 milion është 5 % efitimit.

Tatimi i thjeshtuar për biznesin e vogël administrohet nga Drejtoria Rajonale Tatimore, e cila në roline agjentit tatimor mban një komision prej 1% të vlerës së grumbulluar, ndërsa 99% kalon në favor të bashkisë Vorë.

Të ardhurat nga Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël për vitin 2017 parashikohen 2,100,000 lekë.

b. Të ardhura nga Taksa mbi pasurinë e paluajtshme

Këto të ardhura përfshijnë të ardhurat nga :

- Taksa mbi ndërtesat (mbi ndërtesat e banimit dhe mbi ndërtesat e tjera
- Taksa mbi tokën bujqësore
- Taksa mbi truallin

Të ardhura nga taksa mbi ndërtesat Taksa mbi ndërtesat e banimit Baza e taksës është sipërfaqja e ndërtimit në metër katror e ndërtesës ose e pjesës së saj mbi dhe nën nivelin e tokës dhe për çdo kat. Gjatë vitit parashikohet zgjerimi i bazës së taksapaguesve nëpërmjet saktësimit dhe vlerësimit të drejtë të sipërfaqeve nëpërmjet grupeve të punës të ngritura për këtë qëllim. Bashkia Vorë parashikon që të gjejë mbështetje edhe tek institucionet e tjera si Zyra vendore e regjistrimit të pasurisë për saktësimin dhe përpilimin e një regjistri sa më të saktë të banesave në territorin e saj.

Të ardhura nga Taksa mbi pasurinë e paluajtshme për vitin 2017 parashikohen 132,354,000 lekë.

c. Të ardhura nga taksa e fjetjes në hotel

Cdo subjekt tregtar që jep strehim kundrejt pagesës dhe përfshin emërtimet hotel, motel, stabiliment turistik, pension, shtëpi pritjeje, turizëm familjar dhe çdo objekt tjetër që përdoret për këtë qëllim. Baza e taksës së fjetjes në hotel është numri i netëve të qëndruara në hotel për person, dhe përcaktohet me ligj.

Planifikimi i të ardhurave 225,000 lekë për vitin 2017 është bërë duke parashikuar kapacitetet, numrin e njësisë dhe periudhat e shfrytëzimit.

d. Të ardhura nga taksa e ndikimit në infrastrukture nga ndërtimet e reja

Në këtë taksë përfshihen edhe të ardhurat e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga procesi i legalizimit. Në parashikimin e të ardhurave nga kjo taksë është llogaritur që vlera prej 97,108,000 lekë vlerë e cila mendojmë që të realizohet nga procesi i legalizimit të objekteve pa leje në territorin e qytetit të Vorës dhe në të gjithë fshatrat për rreth, njëkohësisht edhe në njësinë Prezë dhe Bërxullë si dhe mbi parashikimin e lejeve për ndërtime të reja.



Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja administrohet nga Bashkia Vorë. Bazuar në ligjin 9632, taksa e ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet e reja përcaktohet në kufijtë 4-8% e çmimit të shitjes për ndërtime për qëllime banimi apo njësi shërbimi nga shoqëritë e ndërtimit. Taksa e ndikimit në infrastrukture te ndryshme nga ato të përmendura më lart është 3 % të vlerës së investimit që kërkohet të kryhet. Bazuar në Ligjin Nr. 9482 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, taksa për ndërtesat në proces legalizimi llogaritet 0,5% e vlerës së investimit.

e. Të ardhura nga taksa mbi kalimin të drejtës pronësisë për pasuritë e paluajtshme

Kjo taksë administrohet nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme. Taksa me nivelet sipas Ligjit Nr.9632 paguhet para kryerjes së regjistrimit nga personi që kalon të drejtën e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme, dhe vendoset për ndërtesat dhe të gjitha pasuritë nga zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, të cilat, në rolin e agentit tatimor përfitojnë 3% të shumës së arkëtuar dhe diferencën e derdhit për llogari të buxhetit përkatës të bashkisë Vorë. Planifikimi prej bëhet nga agjenti tatimor, i cili është bazuar në eksperiencën e viteve të kaluara. *Të ardhura nga Taksa mbi kalimin e të drejtës pronsisë për pasuritë e paluajtshme për vitin 2017 parashikohen 2,000,000 lekë.*

f. Të ardhura nga Taksa e regjistrimit të automjeteve

Detyrimi për pagimin e taksës i takon pronarit të mjetit. E ardhura nga taksa, mblihet nga strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor (drejtoritë rajonale) para kryerjes së kontrollit teknik vjetor të detyrueshëm të mjetit. Për mjetet që regjistrohen për herë të parë, taksa llogaritet proporcionalisht për periudhën e mbetur të vitit. Procedura e ndarjes së të ardhurave me buxhetet e njërive të qeverisjes vendore përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave, bazuar në numrin e mjeteve të regjistruara sipas njërive të qeverisjes vendore por e konvertuar në përqindje, në masën 18 % e të ardhurave vjetore.

Të ardhura nga Taksa e rregjistrimit te automjeteve për vitin 2017 parashikohen 2,000,000 lekë.

g. Të ardhura nga taksa e tabelës.

Taksa e tabelës aplikohet për tre lloje tabelash, të përcaktuara sipas qëllimit të përdorimit dhe mënyrës së vendosjes së tyre:

- Tabela për qëllime identifikimi
- Tabela për qëllime reklamimi
- Tabela për qëllime ekspozimi

E ardhura nga kjo taksë për vitin 2017 parashikohet të jetë 8,400,000 lekë.



II.1.2 Të ardhurat nga tarifat vendore

Në këtë grup të ardhurash përfshihen të gjithë të ardhurat me natyrë jo tatimore, që rezultojnë nga ofrimi i shërbimeve publike, të drejtat e përdorimit të pronave publike dhe vendore, dhënien e lejeve, licencave, autorizimeve etj. Këto të ardhura zëne rreth 27 % të të ardhurave të veta të bashkisë. Për vitin 2017 planifikimi i këtij zëri është në vlerën 111,247,000 lekë.

Bashkitë vendosin vetë për nivelin, mënyrën e mbledhjes dhe të administrimit të tarifave vendore, në përputhje me politikat dhe parimet e përgjithshme kombëtare të përcaktuara në ligjet në fuqi. Kriteri bazë për vendosjen e një tarife për shërbimin publik është kostoja e tij, dhe paguhet nga familjet apo bizneset të cilët kontribuojnë dhe e përfitojnë këtë shërbim.

Parashikimi i të ardhurave nga biznesi bëhet duke u bazuar në kapacitete, si dhe në shtrirjen e mëtejshme të bazës taksapaguese falë politikave fiskale lehtësuese, përmirësimit të shërbimit dhe marrëdhënies me taksapaguesin, fokusimit në zona me kapacitete të pashfrytëzuara, si dhe sensibilizimin dhe trajtimin e biznesit si partner në dhënien e shërbimeve për komunitetin.

Më poshtë po japim planifikimin sipas zërave të këtij grupi të ardhurash.

a. Tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave

Tarifa, paguhet nga të gjithë familjet, personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, që banojnë ose ushtrojnë veprimtari ekonomike brenda territorit të Bashkisë Vorë. Kjo tarifë është vjetore dhe likuidimi i saj detyrimisht bëhet brenda 20 Prillit të çdo viti. Bashkia vijon të përballet me evazionin fiskal të të ardhurave por pavarësisht kësaj një pjesë e mirë e shërbimeve publike vazhdon të financohet nga të ardhurat e taksave dhe tarifave vendore.

Parashikimi për tarifën e pastrimit dhe largimit të mbeturinave, të ndara sipas kategorive “biznes” dhe “familjare” është në shumën 37,308,000 lekë.

b. Tarifa e ndriçimit

Kjo tarifë gjithashtu është vjetore dhe likuqdohet sipas kategorizimit “biznes” dhe “familjare”.

E ardhura nga kjo tarifë për vitin 2017 parashikohet të jetë në vlerën 4,031,000 lekë.

c. Tarife për shitje toke

Për kompletimin e dosjes me dokumentacionin e kërkuar në rastin e shitjes së tokës bujqësore, procedure kjo e realizuar nga sektori i Bujqsisë si dhe për shërbime të tjera të ofruara nga kjo zyrë për këtë proces, është planifikuar tarifa për shitjen e tokës bujqësore.

Kjo tarifë paguhet në momentin e shitjes së tokës bujqësore. Pala shitëse në momentin e deklarimit të shitjes paguan, në bazë të kategorisë së tokës si me poshtë

E ardhura nga kjo tarifë për vitin 2017 parashikohet të jetë në vlerën 4,000,000 lekë.



d. Tarifë për hapsirat publike

Kjo tarifë paguhet për zënien e hapësirave publike për qëllime biznesi. Këshilli Bashkiak vendos për nivelin, rregullat bazë për administrimin dhe mbledhjen e kësaj tarife, si dhe mund të caktojë nivele të ndryshme të kësaj tarife, sipas nivelit të zhvillimit të veprimtarisë së biznesit në zona të ndryshme të qendrës së banuar. Niveli tregues i tarifës së hapësirës publike është:

- Hapësira publike brenda pedonale (Qendra e qytetit Vorë) - 1000 lek/tavolinë/ditë
- Hapësira publike jashtë pedonale - 100 lek/tavolinë/ditë
- Zënia e hapësirës publike nga automjetet përkatëse të subjekteve - 66 lek/m²/muaj

E ardhura nga kjo tarifë për vitin 2017 parashikohet të jetë në vlerën 216,000 lekë.

e. Të ardhurat nga tarifa për leje transporti

Për dhënie të lejeve të transportit të udhëtareve dhe të mallrave dhënia e shumës së licencës është 5(pesë) vjecare kurse e certifikatës është vjetore e ndarë sipas subjekteve Person juridik dhe Person fizik. Këshilli Bashkiak vendos për nivelin, rregullat bazë për administrimin dhe e kësaj tarife, si dhe mund të caktojë nivele të ndryshme të kësaj tarife.

E ardhura nga kjo tarifë për vitin 2017 parashikohet të jetë në vlerën 4,000,000 lekë.

f. Të ardhura nga tarifa të shërbimit administrativ të bashkisë

Në këtë grup të ardhurash bëjnë pjesë të gjitha shërbimet që ofron bashkia :

- Të ardhura nga Tarifa e kontrollit të zhvillimit të territorit
- Të ardhura nga Tarifa për vulosje veterinare të bagëtive të therura
- Të ardhura nga Tarifat e liçensimit të veprimtarive të transporti
- Të ardhura nga Tarifat e shërbimeve të mbrojtjes nga zjarri
- Të ardhura nga Tarifa për tregun e lire
- Të ardhura nga Tarifa e ujit

Të ardhura nga tarifat administrative për vitin 2017 parashikohen 61,692,000 lekë.

II. 1.3 Të ardhura nga burime të tjera

Për këtë zë të të ardhurave për vitin fiskal 2017 është parashikuar një shumë prej 49,792,000 Lekë ku përfshihen :

- Të ardhura nga kundërvajtjet administrative
- Të ardhura nga dhënia me qera e aseteve në pronësi të bashkisë
- Të ardhura nga sekuestime dhe zhdëmtime
- Detyrime të prapambetura
- Të tjera (aluizmi, gjoba)

Strukturat e ngarkuara për vjeljen e këtyre taksave dhe tarifave, të vendosura dhe të miratuara në Paketën Fiskale 2017, janë sektorët përkatës dhe punonjësit e Bashkisë Vorë.



II. 2Të ardhurat nga burimet qëndrore

Të ardhurat nga burimet qëndrore përfshijnë të ardhurat nga transfertat e pakushtëzuar, transfertat e kushtëzuar dhe transfertat specifike niveli i të cilave përcaktohet çdo vit në ligjin e buxhetit të shtetit.

2.1 Transferta e Pakushtëzuar

Transfertat e pakushtëzuara, që buxheti qendror ia transferon pushtetit vendor, përfshijnë fondet për përballimin e veprimtarive dhe të funksioneve që përcaktohen në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Kjo transfertë është një e ardhur e përfituar në formën e dhurimit pa kusht kthimi dhe pa interes. Transfertat e pakushtëzuara shpërndahen ndërmjet njësive të pushtetit vendor, sipas formulës së përcaktuar. Bashkitë, duhet të përdorin jo më pak se 40 % të transfertës së pakushtëzuar, për investime publike.

Rritja vjetore dhe afatmesme e transfertës së pakushtëzuar parashikohet në udhëzimin vjetor të Ministrisë së Financave “Për hartimin e buxhetit vendor”. Transferta e pakushtëzuar për vitin buxhetor që planifikohet, njoftohet nga Ministria e Financave përpara hartimit të buxhetit të vitit.

Për vitin 2017 , transfertat e pakushtëzuar e cila ndahet sipas formulës për 61 bashkitë , për bashkinë Vorë shuma totale është 114,534,000 lekë.

2.2 Transferta e Kushtëzuar

Transferta e kushtëzuar jepet për financimin e një pjese të shpenzimeve për funksionet e përbashkëta dhe për financimin e shpenzimeve për funksionet e deleguara. Transferta e kushtëzuar përbëhet nga fondet e deleguara për mbulimin e shërbimit të Gjëndjes Civile, Qendrës Kombëtare të regjistrimit, fondet për mbështetje me ndihmë ekonomike për familjet në nevojë, për personat me aftësi të kufizuara. Këto fonde përdoren vetëm për qëllimin për të cilin janë miratuar.

Njësitë e qeverisjes vendore nuk mund të përdorin për qëllime të tjera, përveç atyre të përcaktuara në ligjin për buxhetin. Shumat e këtyre transfertave, të mbetura të papërdorura në fund të vitit buxhetor, nuk mbarten në vitin pasardhës, por rikthehen në buxhetin e shtetit. Mbeshtetur kjo në ligjin nr147/2015 date 17.12.2015 “Per buxhetin e viti 2016”, si dhe në shkresën nr. 18025 Prot, date 28.12.2015, Ministria e Financave, Drejtoria e Menaxhimit të Buxhetit.



2.3 Transfertat specifike sipas funksioneve

Transfertat specifike janë transferata të cilat janë alokuar nga Qeveria për financimin e shpenzimeve për funksionet e reja që i janë transferuar bashkisë. Në këtë fond për arsimin parashkollor, arsimin parauniversitar, për administrimin e pyjeve dhe për ujitje dhe kulliminpërfshihen fondet për paga dhe sigurime shoqërore të personelit (punonjës ndihmës dhe edukatorët) si dhe shpenzimet operative për disa nga funksionet.

Konkretisht për vitin 2017 transfertat specifike, në bazë të ligjit për buxhetin e shtetit dhe sipas shkresës nr 14900/9 Prot, datë 17.11.2016, protokolluar me tonën me nr 4535 Prot, datë 22.11.2016, Bashkisë Vorë i janë alokuar transfertat specifike të mëposhtëme:

Nr.	Emërtimi i transfertës Specifike	Nr. Punonjesve	Fondi 600 – 602
1	Arsimi parashkollor	46	31,519,000
2	Arsimi parauniversitar	4	3,372,000
3	Mbrojtja nga zjarri	11	10,660,000
4	Administrimi i pyjeve	1	615,000
5	Rruget	1	475,000
4	Ujitje -Kullim	1	8,787,000
	TOTALI		55,428,000

2.4 Fondi i Zhvillimit të Rajoneve

Fondi për Zhvillimin e Rajoneve është një instrument zhvëllimor dhe një mekanizëm financiar konkurrues që mbështet politikën kombëtare të zhvillimit rajonal dhe lokal, për të siguruar zbatimin e objektivave të politikës së kohezionit territorial, për të patur rajone me zhvillim të balancuar, konkurruese dhe me zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, social e mjedisor. FZHR-ja mbështetet në tre shtylla kryesore: Programi i Infrastrukturës Vendore dhe Rajonale Vendore; Programi i mbështetjes për ekonomine dhe Programi “Shqipëria dixhitale”. Njësitë e qeverisjes vendore, përfitojnë fonde për financimin e projekteve për të cilat aplikojnë. Projektet miratohen nga Komuniteti i Zhvillimit të Rajoneve, mbi bazën e politikave dhe programeve të zhvillimit të rajoneve të Shqipërisë, i cili përcakton dhe masën e kontributit/bashkëfinancimit nga njësitë e qeverisjes vendore. Komiteti merr vendime bazuar në raportet e sekretariateve teknike të Ministrive të Linjës, të cilat bëjnë vlerësimin tekniko-ekonomik dhe listimin e projekteve



tëpropozuara nga njësiti e qeverisjes vendore, bazuar në VKM nr.135, datë 03.02.2010 për “Përcaktimin e kriterëve për ndarjen e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve”.

Bashkia Vorë është financuar nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve për investimin në:

- Sistemim Asfaltim rruge lidhëse Urbane Fushe Preze Ura e Limithut Bërxulle dhe sistemim, asfaltim I rruges Gjegj-Fushe, Njësia Prezë me vlerë : 74,471,934 lekë.

Të Ardhurat nga Burimet Qëndrore	2017
Transferta e pakushtëzuar	114,534,000
Transferta specifike	55,428,000
Fondi nga FZHR-ja	74,471,934
T O T A L I	224,433,934



KAPITULLI III. PARASHIKIMI I SHPENZIMEVE PËR VITIN 2017

Programimi i shpenzimeve të përgjithshme sipas funksioneve të Bashkisë Vorë për vitin 2017 parashikohet në vlerën 661,324,630 lekë. Bashkia Vorë në planifikimin dhe menaxhimin e shpenzimeve në këtë buxhet synon:

- Procedura të buxhetimit të fokusuar tek produkti/rezultati, për çdo program ne veçanti.
- Transparençën e plote e perdorimit të fondeve publike;
- Planifikimin e investimeve afatgjata dhe prioritare duke sjellë cilësi në rritje vlerësimin e zgjedhjes së projekteve të investimeve duke mbajtur parasysh kërkesat më emergjente dhe të domosdoshme për plotësimin e nevojave të komunitetit, të bazuara në vlerësime dhe studime paraprake.
- Rritjen e shpenzimeve të mirëmbajtjes në shërbimet publike duke iu përgjigjur në këtë mënyrë tendencës të rritjes së investimeve në vite.
- Duke paraqitur një buxhet të balancuar (pa defiçit) të ardhurat = shpenzimet, dhe të besueshëm.
- Gjithëpërfshirës dhe në koherencë me nevojat e qytetarëve

Shpenzimet e përgjithshme ndahen në :

– Shpenzime kapitale

Në investimet kapitale përfshihen: Investime të reja të planifikuara, sipas programeve të zhvillimit, në masën 25% të totalit të investimeve; Objektet në vazhdim nga vitet e mëparshme, në masën 70% të totalit të investimeve; Investime në blerje të ndryshme në masën 5% të totalit të buxhetit.

Për vitin 2017 fondi total për shpenzime kapitale është në shumën 350,268,265 lekë ose 53% ndaj totalit të shpenzimeve.

– Shpenzime korente

Shpenzimet korente përbëhen nga: shpenzimet për personelin dhe shpenzimet operative për realizimin e funksioneve kryesore të bashkisë. Planifikimi synon rritjen e shpenzimeve për përmirësimin dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve publike nëpërmjet shpërndarjes sa më të drejtë të burimeve midis programeve prioritare të zhvillimit dhe nevojave të qytetarëve.

Shpenzimet korente për vitin 2017 parashikohen në shumën 311,056,365 lekë dhe përbëjnë 47% të totalit të shpenzimeve për këtë vit buxhetor.

Raporti mes shpenzimeve korente dhe atyre kapitale është respektivisht 47% dhe 53%.



Shpenzimet e përgjithshme sipas natyrës ekonomike në buxhetin e vitit 2017 paraqiten si me poshtë :

Programet Buxhetore	Shpenzimet Personeli	Shpenzime Operative	Transferta	Investime	Totali
Programi Buxhetor i Shërbimeve Publike Vendore	7,545,400	85,776,713	-	-	93,322,113
Programi Buxhetor i Administratës	97,603,400	40,546,229	-	-	138,149,629
Programi Buxhetor i Isfrastrukturës Rrugëve	-	-	-	350,268,265	350,268,265
Programi i Buxhetor i Arsimit, Kulturës, Rinisë, dhe Sporteve”	-	7,850,000	-	-	7,850,000
Programi i Buxhetore i Përkrahjes Sociale	-	10,000,000	-	-	10,000,000
Programi Buxhetor i Mbrojtjes nga zjarri	-	3,000,000	-	-	3,000,000
TOTALI I PROGRAMEVE	105,148,800	147,172,942	-	350,268,265	602,590,007
F. Rezerve & Kontigjenca	-	-	3,306,623	-	3,306,623
Fuksionet e deleguara (paga.sigurime,shpz.operativ)	-	-	55,428,000	-	55,428,000
TOTALI	105,148,800	147,172,942	58,734,623	350,268,265	661,324,630

3.1 Shpenzime personeli

Totali i shpenzimeve të personelit te administrates (paga dhe sigurime shoqërore) për të gjitha funksionet e Bashkisë Vorë dhe funksionet e deleguara është parashikuar në shumën 105,148,800 lekë dhe kane peshe specifike rreth 15.9% të totalit të buxhetit.

Fondi pagave për vitin 2017 është planifikuar në një nivel më të lartë se viti i mëparshëm për arsye të shtimit të nr të punonjësve dhe në përmbushje të funksioneve të reja të bashkisë si dhe shtrirjes së shërbimeve publike edhe në njësitë administrative Prezë dhe Bërxullë. Theksojmë se fondi për financimin e shpenzimeve të personelit për funksionet e reja është alokuar nëpërmjet transfertës specifike dhe nr i punonjësve për këto funksione ka ardhur i përcaktuar nga Ministrinë e linjës që mbulojnë këto funksione.



Tranferata te brendeshme jane 8,330,663 leke te cilat perbehen nga transferimi per ekipin e futbollit “Vora “ 8,000,000 leke dhe transferime nga këshillin e qarkut Tirane ne vleren 330,663 leke qe eshte 0.05% i vendosur nga këshilli Bashkiak Vore.

Njësitë Shpenzuese	Nr.punonjë sve	Paga	Sigurimet shoq. dhe shënd.	TOTALI
Administrata	183	66,780,000	10,621,200	77,401,200
Njesia Admin. Preze	43	8,925,000	1,419,500	10,344,500
Njesia Admin. Bexull	40	8,505,000	1,352,700	9,857,700
Shërbimet publike	93	6,510,000	1,035,400	7,545,400
TOTALI	359	90,720,000	14,428,800	105,148,800

3.2 Shpenzime operative

Për vitin 2017, në total shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes janë projektuar në shumën 85,776,713 lekë, këto shpenzime zënë 12.9 % të totalit të buxhetit. Këtu është përfshirë edhe fondi për ofrimin e shërbimit të pastrimit ne Njësite Administrative .Racionalizimi i shpenzimeve operative dhe dhe të administratës vazhdon të jetë pjesë e pandryshuar e programit të shpenzimeve për vitin 2017. Tabelat me të gjitha zërat e shpenzimeve operative sipas programeve gjenden në fund të materialit të buxhetit.

Shpenzimet operative të Arsimit, Kulturës, Rinisë, Turizmit dhe Sportit për vitin 2017 janë parashikuar në vlerën 7,850,000 lekë dhe kanë peshë specifike rreth 1.5% të totalit të buxhetit.

Gjithashtu është parashikuar 2% e buxhetitn për përkrahje sociale për familjet në nevojë, kjo shumë është parashikuar në vlerën 10.000.000 lekë

3.3 Fondi rezervë dhe kontigjenca

Fondet speciale (Fondi rezerve dhe Fondi Kontigjenca) janë parashikuar në vlerën 3,306,623 lekë dhe kanë peshë specifike rreth 0.5 % të totalit të buxhetit.



KAPITULLI IV PROGRAMET BUXHETORE

Ky kapitull, prezanton me hollësi politikat, qëllimet, objektivat dhe produktet e secilit prej programeve të zhvillimit që parashikohen të realizohen për periudhën në vazhdim nga të gjitha njësitë shpenzuese në bashkinë Vorë.

Bazuar në funksionet e veta, të përbashkëta e të deleguara të pushtetit vendor, përcaktuar në Ligji nr. 139/2015 “Per veteqeverisjen vendore”, në strukturat buxhetore të programeve që parashikojnë aktet ligjore mbi buxhetin si edhe në funksionet që ushtron aktualisht bashkia, programet buxhetore janë si vijon:

- Programi Buxhetor i Shërbimeve Publike Vendore,
- Programi i Buxhetor i Infrastrukturës Rrugëve ,
- Programi Buxhetor i Administratës
- Programi i Buxhetor i Arsimit, Kulturës, Rinisë, dhe Sportit
- Programi Buxhetor i shërbimeve dhe Kujdesit Social ”
- Programi Buxhetor i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpetimi

Totali i shpenzimeve (korente dhe kapitale) në lekë, për çdo program mbështetur në të ardhurat që do të realizojë bashkia Vorë paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Në lekë

Programi	Buxheti 2017
Programi Buxhetor i Shërbimeve Publike Vendore	97,770,713
Programi Buxhetor i Infrastrukturës Rrugëve	350,268,265
Programi Buxhetor i Administratës	133,701,029
Programi Buxhetor i Arsimit, Kulturës, Rinisë, dhe Sportit	7,850,000
Programi Buxhetor i Shërbimeve dhe Kujdesit Social	10,000,000
Programi Buxhetor i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpetimi	3,000,000
TOTAL	602,590,007



4.1 Programi Buxhetor i Administratës

– Politika e Programit

Politika e këtij programi konsiston në përmirësimin e funksionimit dhe menaxhimit të Bashkisë Vorë, zhvillimit të kapaciteteve menaxhuese dhe garantimin e përmirësimit të vazhdueshëm të burimeve njerëzore dhe përdorimit me efektivitet të burimeve financiare.

– Qëllimi i Politikës

Ky program parashikon menaxhimin financiar të Bashkisë dhe përfshin shpenzimet e nevojshme administrative për funksionimin normal të administratës vendore dhe përbushjen e misionit të bashkisë Vorë për mobilizimin dhe përdorimin me efikasitet dhe efektivitet të burimeve financiare publike, për realizimin e qëllimeve dhe objektivave, të politikave të mandatuara.

– Objektivat e Politikës

1. Përmirësimi në vazhdimësi i aftësive drejtuese të stafit të Bashkisë dhe niveleve të tjera të vendimmarrjes në varësi të saj,
2. Hartimi dhe propozimi i ndryshimeve në politikën fiskale, me qëllim mbështetjen e vazhdueshme të rritjes ekonomike,
3. Ndërtimin e një sistemi efektiv të programimit buxhetor, mbi bazë programesh Buxhetore,
4. Menaxhimi aktiv me bazë koston dhe riskun,
5. Përmirësimi i menaxhimit dhe përdorimit të fondeve publike me transparencë, efikasitet, ekonomike dhe implementimin e zhvillimin e një sistemi bashkëkohor e të qëndrueshëm për kontrollin e brendshëm financiar, me një shërbim të pavarur e funksional të auditimit të brendshëm,
6. Krijimi i një institucioni efikas, ku të përmirësohen në vazhdimësi aftësitë e stafit drejtues, kapacitetet institucionale dhe teknike, me qëllim administrimin korrekt të fondeve,
7. Të asistohen dhe nxiten tatimpaguesit në mënyrë që të likuoidjnë detyrimet në përputhje me kërkesat e legjislacionit tatimor, duke siguruar që të ardhurat nga taksat dhe tarifatat vendore, të shkojnë për llogari të buxhetit të Bashkisë Vorë,
8. Të sigurohet zgjerimi i bazës së taksueshme, rritja e numrit të taksapaguesve, dhe reduktimi i elementëve të evazionit,
9. Forcimi i auditimit mbi bazën e riskut,
10. Për një shërbim të ndershëm, të plotë dhe cilësor për biznesin dhe qytetarët,
11. Krijimi i sistemit të informacionit dhe bankave të nivelit të dytë, për ofrimin e shërbimit ndaj taksapaguesve,
12. Fushata informative dhe sensibilizuese për ndërgjegjësimin e publikut për detyrimet ligjore ndaj Bashkisë,
13. Organizimi i trajnimeve me stafin e ri dhe atë ekzistues,
14. Përmirësimi i ambjenteve të punës për punonjësit e Bashkisë,
15. Mirëmbajtja e sistemit kompjuterik dhe faqes së internetit të Bashkisë për pasqyrimin me transparencë të punës së Bashkisë,
16. Përmirësimi i legjislacionit vendor dhe përafrimi i tij me standardet e BE, lidhur me menaxhimin e mjedisit, administrimin e ndërtesave dhe aseteve të tjera të Bashkisë si dhe në fushën e planifikimit territorial.



4.2 Programii Shërbimeve Publike Vendore

- Politika e Programit

Politika e Shërbimeve Publike Vendore synon në përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve dhe mbrojtjes së ambjentit kundrejt zhvillimit urban të qytetit.

- Qëllimi i Politikës

Kjo politikë ka për qëllim ofrimin me cilësi, sipas standardeve bashkëkohore të shërbimeve publike në të gjithë territorin: Shtimin e sipërfaqeve të gjelbërta; Shtimin e ambjenteve shlodhëse; argëtuesedhe sportive, Përmirësimin e infrastrukturës së kanalizimeve të ujrave të zeza; Përmirësimin e shërbimit të mbledhjes së mbetjeve urbane; Investimet për shërbimet publike.

- Standardet e politikës

Standarde bashkëkohore do të përdoren për të vënë në funksionim këtë program në të gjithë territorin Administrativ të Bashkisë Vore duke u bazuar në standardet më të mira në vend dhe ato të vëndeve të zhvilluara.

- Objektivat e Politikës së Programit

Në përmbushje të qëllimit të politikës, objektivate këtij programi fokusohen në zhvillimin dhe mirëmbajtjen e hapësirave publike, pajisjen e tyre me elementët e nevojshëm për sigurimin e një mjedisi bashkëkohor dhe rritjen e cilësisë së jetesës së qytetarëve:

1. Rehabilitimi i sipërfaqeve të gjelbërta egzistuese;
2. Shtimi i sipërfaqe të gjelbërta;
3. Shtimi i ambjenteve shlodhëse, argëtuese dhe sportive
4. Mirëmbajtja e Rrugeve, kanalizimeve të ujrave të zeza e te bardha.
5. Mbulimi me shërbimin e mbledhjes së mbetjeve urbane të të gjithë territorit.
6. Shtimi i kapaciteteve grumbulluese të mbetjeve urbane.
7. Pastrimi i qytetit dhe shërbimi i ndriçimit të qytetit.
8. Mirëmbajtja e varrezave.

4.3 Programi i Infrastrukturës Rrugore

- Politika e Programit

Politika e menaxhimit të rrugëve synon në përmirësimin të jetës së qytetarëve dhe mbrojtjes së ambjentit kundrejt zhvillimit të rrjetit rrugor.

- Qëllimi i Politikës

Metoda efikase për menaxhimin e kërkesës dhe sigurimin e një informacioni më të mirë për të rritur lëvizshmërinë në zonen e bashkisë Vore dhe të hyrje daljeve. Rritja e cilësisë së Rrugeve eksistuese dhe ndertimi i rrugëve të reja. Përmirësimi i gjithë instrumentave dhe elementëve të sinjalistikës rrugore në qytet dhe zonat perreth.



- Standardet e politikës

Për projektimin e rrugëve të reja shpejtësia e projektimit në qendrat banuara është deri në 40km/h; .

- Objektivat e Politikës së Programit

Rehabilitimi i rrugëve egzistuese me rëndësi për përmirësimin e lëvizjes së njerëzve dhe mallrave; Ndërtimi i rrugëve të reja duke rritur kapacitetet e rrjetit rrugor,

- **Shpenzimet kapitale për vitin 2017**

Objekte në vazhdim:

1. Rikonstruksion, Sistemim dhe Asfaltim I Rrugëve të Brëndëshme Lagje Kodër Vorë Loti 2”.
2. Sistemim dhe Asfaltim i Rrugeve te Brendshme Lagje e Re Vore. Loti 3.
3. Sistemim, Asfaltim i Rrugës ,Rruga Kryesore Lagje Dunga -Varreza (Sektori Marikaj) L=470MI
4. Rikonstruksion, Asfaltim i Rrugeve te Brendshme te fshatit Mucaj Aksi 01.
5. Rikonstruksion Dhe Asfaltim I Rrugeve Te Fshatit Gjokaj, Rruga Zalli I Gjokajve, Rruga Pylli Balliut, Rruga Shehelerve, Rruga E Arave.
6. Sisitemim - Asfaltim i Rruges Pavarsia Fshati Sharge Bashkia Vore
7. Sisitemim - Asfaltim Rruges se Mimosave Koder Vore, Bashkia Vore (Perballe godines se bashkise Vore)
8. Sistemim - Asfaltim Rruges Allcaushaj Fshati Marikaj, Bashkia Vore
9. Sistemim - Asfaltim Rruges Toptaneve Fshati Marikaj, Bashkia Vore
10. Sistemim - Asfaltim Rruga Kodra e Xhirajve Fshati Marqinet, Bashkia Vore
11. Sistemim, Asfaltim Rruges Bashkimi Vore, Bashkia Vore. Lidhja e Rruges Kodra e Bukur me Rrugen Fusha e Sportit)
12. Sistemim, Asfaltim i Dy Segmenteve te Rruges Rilindja Fshati Marqinet (2), Segmenti 1 dhe 2 , Bashkia Vore.
13. Rikonstruksion dhe Asfaltim I rruges Sul-Haxhi
14. Sisitemim Asfaltim I rruges se fshatit Koder Berxulle
15. Ndertim dhe/ose Rikonstruksion I Komisarariatit te Policise Vore

Objekte të reja të parashikuara për vitin 2017 :

1. Rhabilitim I lumit Lanan dhe ndertim I K.U.Z, Rruga "Kreta", "Pashtriku", "Muharrem Bajraktari", Domje, Laknas, Bashkia Vore
2. Sistemim - Asfaltim I rrugeve Domje, Rruga Ramadin Zazckocki + Rruga Kodra e Toteve, Rruga Ismail Qemali, Rruga Naim Frasheri , njesia administrative Berxull, Bashkia Vore
3. Sistemim - Asfaltim Rruga Vromit (Ahmetaq) L=870, Bashkia Vore
4. Sistemim - Asfaltim Rruga Ibrahimet L=370 , Bashkia Vore
5. Ndertimi I Ures dhe vendosja ndricimit, Fushe Preze
6. Vendosja e ndricimit lagjia Mucaj



7. Sistemim - Asfaltim Rruges Mara, Marikaj , Bashkia Vore
8. Sistemim - Asfaltim vazhdim I Rruges Allcaushaj (Faza II), Fshati Marikaj dhe sistemim-asfaltim segmenti I Rruges se Llanajve, Marqinet, Bashkia Vore
9. Sistemim - Asfaltim Rruges Hasrameve dhe Taruceve, Bashkia Vore
10. Ndertim I KUZ Rruga Taruceve, Muçaj

4.4 Programi I Arsimit, Kulturës, Rinisë dhe. Sportit

- Politika e Programit

Programi i Arsimit, Kultures, Rinise dhe Sportit parashikon hartimin e politikave në përmirësimin e infrastrukturës arsimore dhe kushteve të mësimdhënies ne shkollat dhe kopeshte. Persa i takon kulturës synon identifikimin e të gjitha pasurive kulturore dhe artistike të zones dhe pasurimin e jetës sociale, kulturore e artistike për qytetarët, duke ndikuar në këtë mënyrë drejtpërdrejtë në imazhin e bashkise.

Parashikon organizimin e aktiviteteve te ndryshme rinore dhe sportive. Ky program do te sherbeje per zhvillimin e qytetit te Vores si nje qytet plot gjalleri.

- Qëllimi i Politikës

Politika e programit ka si qëllim prioritar, propozimin e projekteve të Qeverisjes Vendore për ndërtimin e godinave të reja shkollore dhe parashkollore në të gjithë territorin e Bashkise Vore, për shkak të rritjes së demografisë dhe zhvillimit ekonomik e social duke synuar kështu rritjen e kapaciteteve të arsimit të përgjithshëm parashkollor e shkollor, ka për qëllim intensifikimin e jetës artistike kulturore për të gjitha grupmosha, për përmirësimin e cilësisë së jetesës për të gjithë qytetarët. Duke i nxjerrë në pah vlerat e historinë e hershme të qytetit. Politikat e ketij programi jane te lidhura ngushte me organizmin dhe mbarevajtjen e aktiviteteve te ndryshme rinore per te bere te mundur aktivizimin e rinise jo-aktive si dhe nxitjen, zhvillimin dhe perhapjen e kultures sportive nepermjet organizimit te aktiviteteve te ndryshme me karakter kulturor e sportive. erket forcimit te rolit te bashkise ne evidentimin e problematikave te te rinjve dhe zgjidhjen e tyre.

- Standardet e politikës

Kushte të përmirësuara të sistemit parauniversitarë dhe edukimit, orientim drejt një sistemi modern në dije dhe informacion të të gjithë nxënësve, studenteve dhe qytetarëve si dhe bashkëpunimit intensivisht me botën universitare. Ruajtjen dhe zhvillimin e kulturës, artit dhe turizmit. Rritja e mireqenies sociale permes zbatimit te programeve te ndryshme social-kulturore e sportive, ngritjes se qendrave ditore per te gjitha kategorite e grupmoshat.

- Objektivat e Politikës së Programit

1. Mirembajtjen e objekteve arsimore (Shkollat dhe Kopeshtet)
2. Mobilimi i objekteve arsimore me të gjithë elementët për një proces mësimdhënie cilësor.
3. Garantimin e objekteve arsimore me sisteme ngrohje.
4. Pajisja e objekteve që rikonstruktohen me palestra, terrene sportive, laboratorë etj
5. Aplikimi dhenjes se shperblimeve për nxënësit e dalluar.



6. Ofrimi i aktiviteteve të shumta kulturore sportive e artistike për nxënësit dhe nga vete nxënësit.
7. Të identifikojë të gjitha vlerat e trashëgimisë kulturore, monumentet e kulturës, traditën folklorike, artizanatin etj.,
8. Të nxisë leximin dhe shkrimin për pasurimin e veprimtarisë në letra si një nga format për mbrojtjen, forcimin dhe promovimin e historisë dhe gjuhës si vlera kulturore etj.,
9. Të organizojë sipas kalendarit festat e traditës, të ditëve kombëtare e ndërkombëtare,
10. Dhenien e shperblimeve per studentet e shkelqyer apo ata me pamundësi ekonomike.
11. Nxitjen e aktiviteteve sportive,.
12. Organizimin e sportit ne shkolla dhe organizimin e aktiviteteve te shumta sportive midis shkollave.

**Bashkengjitur këtij materiali gjenden tabelat e parashkimit të buxhetit për vitin 2017 dhe buxhetin afatmesëm 2018-2019 :*

- Tabela e të ardhurav

- Tabela e Shpenzimeve

- Tabela e Shpenzimeve për paga dhe Sigurime Shoqërore

- Tabela e Investimeve

- Tabela e Shpenzimeve Operative



Punoi materialin e Buxhetit :

Konceptoi/Punoi:

Përgj.Sek.Financës : Aida Dedja

Specialiste Buxheti: Rovena Gjoni

Konfirmuan:

A.Muca

Nëpunës Autorizues

S. Kulli

Administratori njësisë Prezë

A. Zela

Sek.Përgjithshme

B.Ciku

Përgj.Sek Juridik

A.Subashi

Dr.Dr.Taksa Tatimeve

A.Kasa

Përgj.Sherb.Publike

Y.Marku

Zv/Kryetar

K.Haka

Administratori njësisë Bërxullë

M.Shytko

Dr. Burimeve Njerezore

L.Beta

Dr. DPKZHT

H.Mara

Dr. Dr.Bujqesise

Y. Kodra

Dr. Dr.Arsimit



Bashkia Vorë

L.Picari

Pergj.Sherb.Sociale

M.Shera

Pergj.Pronave Publike

A. Cullhaj

Pergj.Sek.Emergjencat Civile

N.Picari

Pergj. MZSH

M I R A T O I

FIQIRI ISMAILI

K R Y E T A R